

**KLSH: NË 2013, NJË DEPARTAMENT AUDITIMI PADIT 75 PUNONJËS PËR ABUZIME.**

nga Fatmir ZILJA – Auditues i parë<sup>1</sup>,

Niko NAKO -Kryeauditues<sup>2</sup>,

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 22 janar 2014



Në KLSH u zhvillua Analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme për vitin 2013. Ky departament synoi kryerjen e audtimeve për vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko financiare në institucionet e qeverisjes vendore dhe njësitë vartëse, në administrimin, kthimin e kompesimin e pronave pronarëve legjitimë, shitjen, dhënien me qira dhe në përdorim të pronës janë programuar 52 auditime dhe ka realizuar realizuar 65 auditime nga të cilat 55 janë evaduar, 1 auditim është në proces evadimi (ZVRPP Tiranë) dhe 9 auditime, do të evadohen gjatë tremujorit të parë 2014.

Nga 65 subjekte të realizuara, 53 auditime janë për zbatimin e ligjshmërisë, 3 janë auditime tematike (komunat Gjinar, Shezë, Suç), ndërsa 9 janë auditime financiare.

Për 55 auditimet e evaduara janë dhënë 1370 rekomandime të natyrave të ndryshme, me qëllim përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituar si më poshtë:

1. Dëm ekonomik në vlerën 599,267 mijë lekë, për 51 subjekte.
2. Masa organizative 783.

3. Masa disiplinore 512.

4. Masa administrative 68.

5. Kallëzime penale në 15 subjekte, për 69 punonjës.

Veç sa më sipër janë rekomanduar:

- Përmirësime ligjore në 6 raste, në 4 subjekte (Bashkia Tiranë, Drejtoria nr. 3 e Bashkisë Tiranë, Shërbimi Spitalor Shëndetësor Krujë, dhe Komuna Zall-Herr).

#### **Realizimi i rekomandimeve**

Brenda afatit 20 ditor të përcaktuar në dokumentet standarde të KLSH, për realizimin e rekomandimeve janë përgjigjur 45 subjekte, ndërsa për 120 masa organizative, meqenëse janë evaduar në fund të vitit 2013, ende nuk është plotësuar afati kohor 20 ditor për kthim përgjigje, por është në pritje për realizimin e tyre.

Në 55 subjekte janë rekomanduar dhe realizuar:

Masa organizative, nga 790 janë zbatuar 586 ose 74% e tyre, prej tyre janë në proces për realizim 148 ose 18% e tyre, pa realizuar 84 masa ose 8%;

Masa disiplinore nga 512, janë realizuar 347, ose 67.7 %, mbetet 165 masa të porealizuara, nga të cilat 100 janë brenda afatit 20 ditor dhe 76 masa nuk pranohen nga subjektet.

Masa administrative nga 68, janë realizuar 29, ose 42.6 %;

Dëmi ekonomik me vlerë 599,267 mijë/lekë, për të cilin sipas përgjigjeve të ardhura nga subjektet, kanë filluar procedurat për ndalimin dhe zbatuar për 13 prej tyre.

Në vlerën e mësipërme, shuma prej 220,565 mijë lekë u përket 12 subjekteve të cilat janë brenda afatit 20 ditor, ndërsa 40 subjekte me dëmin ekonomik prej 379,784 mijë lekë janë realizuar ose janë proces realizimi dhe që pritshmëria është për realizëm rreth 60-65 %.

II. Krahasuar me treguesit e së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, departamenti ka rritje në të gjithë treguesit, si më poshtë:

**1. Dëmi ekonomik, në vitin 2013 është 599,267 mijë lekë, ose 58,778 mijë lekë më shumë se në vitin 2012.**

2. Rastet që përmbajnë elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, janë **paditur** 75 persona në 20 subjekte, me efekt financiar prej 632,300 mijë lekë, nga e cila vlera prej 324,622 mijë lekë përfaqëson të ardhura të munguara të trajtuara (INUK 99,653 mijë lekë, ALUIZNI Shkodër 177,832 mijë lekë, ALUIZNI Vloca 2, vlera 10.137 mijë lekë dhe Bashkia Fier 37,000 mijë lekë. Raportimi i kësaj shume, më tepër se shpërblimi i dëmit, vjen pasi këtu përfshihen vlerat e efekteve të zbulimeve në ALUIZNI-t, të cilat nuk janë rekomanduar si shpërblim dëmi, por si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, ndërkohë që për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar 2012 nuk është raportuar asnjë rast.

Kjo është një risi për Departamentin dhe vet KLSH, duke pasur parasysh që përveç rritjes së performancës, këto auditime kanë pasur ndjeshmëri tepër pozitive në publik dhe tek ish pronarët dhe më tej.

3. **Masa organizative janë rekomanduar** 790, kundrejt 1095 të rekomanduara në vitin 2012. Kjo shihet si pozitive, për shkak se janë eliminuar ndjeshëm rekomandimet për zbatimin e ligjshmërisë kryesisht për procedurat e prokurimit. Rekomandimet e dhëna kanë synuar që masat të mos jenë formale, por produkt i nevojshëm i konstatimeve të dala gjatë auditimit, rezultat i së cilës është arkëtimi i 10,000 mijë lekë nga 15 subjekte.

4. **Në drejtim të përmirësimit ligjor:** Janë rekomanduar 6 përmirësime, kundrejt 4 në vitin 2012, përkatësisht për subjektet Bashkia Tiranë, Drejtoria nr. 3 e Bashkisë Tiranë, Shërbimi Spitalor Shëndetësor Krujë, Komuna Zall-Herrë.

## **5. Realizimi i rekomandimeve.**

### **5.1. Shpërblimi i dëmit të shkaktuar.**

Nga verifikimi i 40 subjekteve me dëm ekonomik prej 379,784 mijë lekë , i cili përbën 64 për qind të vlerës gjithsej, konstatohet se 13 subjekte i kanë realizuar rekomandimet në masën 100%, ndërsa në 12 prej tyre me vlerë 64,822,000 lekë, kanë nisur njoftimet por *ende nuk ka filluar arkëtimi*.

Problem paraqiten 11 subjekte me vlerë dëmi të shkaktuar prej 139,392 mijë lekë, ose rreth 36 % e totalit, të cilat nuk pranojnë rekomandimet e KLSH, me pretendime të ndryshme, duke çuar në uljen e realizimit të tyre në masën rreth 60%.

*Subjekte që nuk kanë pranuar të zbatojnë rekomandimet:*

Bashkia Durrës në vlerën 55,449 mijë lekë, Tiranë 20,961 mijë lekë, Patos 14,722 mijë lekë, Kukës 3837 mijë lekë, Vau-Dejës 8,638 mijë lekë, Fier 1,708 mijë lekë, etj.

Komuna Lukovë 4082 mijë lekë, Buçimas Pogradec 1,805 mijë lekë KQ Gjirokastër 1.120 mijë lekë etj.

*5.2. Realizimi i masave disiplinore dhe administrative.*

Në 55 subjektet e audituara janë rekomanduar 580 masa disiplinore dhe administrative, nga të cilat u verifikuan në 37 subjekte dhe rezultoi se 24 subjekte i kanë realizuar 100 për qind, kurse 13 subjekte e tjerë, nuk kanë realizuar 58 masa, të cilat nuk pranohen nga subjekte, për arsye të ndryshme dhe konkretisht në 8 subjektet si më poshtë:

Bashkia Fier 22 masa, Tiranë 18 masa, Kavajë 4 masa, Durrës 8 masa, Patos 2 masa, Këshilli i qarkut Gjirokastër 2 masa, etj.

Departamenti për të ardhmen duhet:

- Të përsos metodat e auditimit për pjesën e rekomandimeve të porealizuara nga Bashkia Fier, Patos, Koplik, Bashkia Vau Dejës etj, të cilat përgjithësisht nuk kanë zbatuar rekomandimet e kërkuara.

- Të përmirësojë cilësinë e rekomandimeve, ato të jenë koncize, të sakta dhe të kuptueshme dhe për rekomandimet e së njëjtës natyrë të bëhet unifikimi i tyre, në veçanti për masat organizative.

*Kërkesa për zbatimin i rekomandimeve, duhet vlerësuar, pasi ai është produkti i Departamentit. Këmbëngulja për zbatimin e tyre rrit besimin e taksapaguesve dhe imazhin KLSH, në publikun e gjerë.*

---

<sup>1</sup> Shkrime të tjera të botuara nga Fatmir ZILJA për periudhën Janar–Qershor 2014:

- *Standard and Poor's, renditja e Shqipërisë dhe KLSH.*

*(Botuar në gazetën "Ekonomia", më 09 janar 2014.)*

<sup>2</sup> Shkrime të tjera të botuara nga Niko NAKO për periudhën Janar–Qershor 2014:

- *KLSH dhe Inspektoratet Ndërtimore Urbanistike Vendore.*

*(Botuar në gazetën "Ekonomia", më 18 qershor 2014.)*